



VENDIM MBI PRANUESHMËRINË

Data e miratimit: 11 shtator 2019

Nr. i lëndës. 2016-13

Miomir Krivokapić

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 11 shtator 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga
Z. Ron HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 15 janar 2019,

Pas shqyrtimit vendosi si vijon:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa për këtë rast është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Me anë të shkresës të datës 1 korrik 2016, Paneli e ka informuar Misionin se ky rast është regjistruar në Panel.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli i ka kërkuar këtij dhe ankuesve të tjerë që të japin informata shtesë lidhur me ankesat e tyre.

4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli i ka dërguar dy kërkesa shtesë përfaqësuesit të ankuesit lartpërmendur për informata shtesë.
5. Më 20 tetor 2017, Paneli ka pranuar një përgjigje nga përfaqësuesi i ankuesit duke ofruar informata shtesë lidhur me dy raste, duke përfshirë edhe këtë të tanishmin.
6. Më 8 dhjetor 2017, Paneli ia ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve Shefit të Misionit (SHM-së), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar atë që të parashtrijë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesat jo më vonë se datën 26 janar 2018.
7. Përmes letrës së datës 17 janar 2019, nga Misioni ishte kërkuar përsëri që të japë përgjigje për pyetjet deri më 16 shkurt 2019.
8. Përmes letrës së datës 8 prill 2019, nga Misioni ishte kërkuar të bëjë me dije se kur do të jetë në gjendje t'i jep përgjigjet në pyetjet, si dhe edhe një herë i është bërë thirrje që të përgjigjej sa më shpejtë të ishte e mundur.
9. Vërejtjet e SHM-së më në fund u morën më 26 qershor 2019.
10. Përmes letrës së datës 24 korrik 2019, vërejtjet e SHM i janë komunikuar ankuesit, ndërsa nga ai ishte kërkuar që të përgjigjej ndaj vërejtjeve të Misionit nëse donte ta bënte këtë. Nga ankuesi nuk është pranuar asnjë parashtrisë tjetër.

II. FAKTET

11. Faktet e këtij rasti, ashtu siç shihen nga ankesa, mund të përmbliidhen si në vijim.
12. Më 13 shtator 1999 rreth orës 19.00, Arsenije Krivokapić, babai i ankuesit, Miomir Krivokapić, ishte parë duke ecur në drejtim të lagjes së boshnjakëve, Mitrovicë. Ai ishte zhdukur menjëherë pas kësaj dhe më nuk ishte parë.
13. Ankuesi thotë se ai e kishte raportuar zhdukjen e babait të tij në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), në KFOR dhe në UNMIK në kohën e zhdukjes. Më vonë ai e kishte raportuar këtë çështje edhe në EULEX Kosova.
14. Më 17 shtator 1999, KNKK e kishte hapur një kërkesë për gjurmim për Arsenije Krivokapić.
15. Ankuesi thotë se ai dhe as familja e tij nuk kanë dëgjuar më asgjë nga këto autoritete lidhur me babanë e tij prej kohës kur u raportua zhdukja e tij.
16. Më 20 prill 2000, Zorka Krivokapic, bashkëshortja e Arsenije Krivokapić, e ka dhënë një deklaratë për zhdukjen e bashkëshortit të saj para një gjyqtari hetues në Gjykatën komunale të Mitrovicës. Në dy raste të më pasme, më 19 maj 2000 dhe 29 qershor 2002, ajo kishte bërë deklarata plotësuese në Departamentin e Krimeve të Policisë në Mitrovicë.

17. Më 21 gusht 2016, Paneli ka kërkuar sqarime nga Misioni në lidhje me këtë rast dhe me një rast tjetër (2016-12) lidhur me atë nëse Misioni ia kishte komunikuar dosjen e lëndës autoriteteve vendase të Kosovës rreth kohës së ndryshimit të mandatit të këtij Misioni në muajin qershor 2018.
18. Më 23 gusht 2019, Misioni e ka dhënë përgjigjen e tij.

III. ANKESA DHE QËNDRIMI I ANKUESIT

19. Ankuesi i referohet disa të drejtave të veçanta themelore të cilat ai thotë të jenë shkelur në këtë rast, si: a) e drejta për jetë; b) e drejta për lirinë e lëvizjes; c) diskriminimi i bazuar në etni; d) garancia kundër torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor dhe poshtëruës.
20. Për arsyet e dhëna më poshtë, Paneli ka marrë qëndrim që ky rast është i pranueshëm në lidhje me pretendimet e ankuesit në bazë të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dispozitave të ngjashme që i mbrojnë të drejtat themelore të njëjta që janë të aplikueshme përpara këtij Paneli.
21. Duke e pasur parasysh lidhjen e ngushtë familjare ndërmjet viktimës së drejtpërdrejtë – Arsenije Krivokapić – dhe ankuesit – Miomir Krivokapić – Paneli është i bindur që ankuesi mund të konsiderohet si viktimë sekondare e shkeljeve të supozuara dhe, si i tillë, viktimë e mundshme në përputhje me Rregullën 25(1) të Rregullores së Punës të Panelit.

IV. PARASHTRESAT E PALËVE

Ankuesi

22. Siç përmbledhet më lart, ankuesi pretendon se gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX Kosova duhet ta kishte hetuar zhdukjen e babait të tij dhe ka dështuar ta bëjë këtë në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe vëllait të tij.

Shefi i Misionit

23. Më 26 qershor 2019, SHM e ka bërë parashtresën lidhur me pranueshmërinë e këtij rasti.
24. Në përgjigje ndaj pyetjeve të Panelit nëse ky Mision ka qenë në dijeni për ekzistimin e këtij rasti, ky Mision thekson se në kuadër të pranim-dorëzimit të lëndëve dhe dosjeve të lëndëve nga UNMIK-u në EULEX Kosova, ky Mision e ka pranuar një 'Raport hetimor para vdekjes i Njësisë së Policisë të UNMIK-ut për Krimet e Luftës – Seksioni për Personat e Zhdukur' që i referohet zhdukjes së Arsenije Krivokapić që daton nga muaji shkurt 2005. Ky raport thekson se z. Krivokapić ishte zhdukur më 13 shtator 1999, që

rasti ishte raportuar në KNKK në Beograd, që ishte hapur një dosje nga NJPZH në vitin 2002, që në atë kohë ishte e pamundur të gjendet ndonjë dëshmitar për këto ngjarje dhe se rasti duhet të mbahej 'i hapur'/'në pritje' në kuadër të Njesisë për Krime të Luftës (NJKL). Ky raport gjithashtu përmend se bashkëshortja e z. Krivokapić, e cila ishte e listuar si 'dëshmitare', nuk ka mund të kontaktohet.

25. Ky Mision gjithashtu i ka pranuar nga UNMIK-u disa formularë për identifikimin e viktimave me detajet e tij, si dhe një korrespondencë ndërmjet Stacionit të Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë dhe Njesisë së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur (NJPZH) në Prishtinë në nëntor 2000 duke theksuar se zhdukja e z. Krivokapić ishte regjistruar së pari në muajin nëntor 2000.
26. Po ashtu, në mesin e dokumenteve të pranuar nga ky Mision ishte edhe një tjetër raport ante-mortem i përgatitur në një datë të paspecifikuar në vitin 2008 nga një zyrtar policor i UNMIK-ut, i cili theksonte se ky rast duhej të mbahej i hapur në kuadër të Seksionit për Ante-Mortem dhe Zhvarrime' 'në pritje të informatave tjera'. Me gjasë ky dokument nuk i është përcjellë PSRK-së për vlerësim.
27. Prandaj, ky Mision parashtron se, në kohën e pranim-dorëzimit të këtij rasti në EULEX, ky rast nuk ishte duke u hetuar në mënyrë aktive nga UNMIK-u 'për shkak të mungesës së informatave'.
28. Ky Mision nuk ka pranuar dokumente tjera lidhur me këtë rast dhe konstaton se ankuesi nuk i ka bërë me dije atij lidhur me zhdukjen e babait të saj.
29. Në përgjigje ndaj pyetjes së Panelit për këtë pikë, ky Mision e jep një sqarim të detajuar të punës komplekse dhe që ka marrë kohë për shqyrtimin, regjistrimin, ruajtjen dhe analizimin e dosjeve të pranuar nga UNMIK-u.
30. Si pjesë e transferit të tij, UNMIK-u i ka dhënë këtij Misioni disa baza të dhënave. Rasti i z. Mr Krivokapić mbante një numër të NJPZH dhe ishte i regjistruar në bazën e të dhënave për personat e zhdukur që UNMIK-u ia kishte dorëzuar këtij Misioni.
31. Ky Mision gjithashtu thotë se përmbajtja e dosjeve të policisë për 'krimet e luftës' dhe për 'personat e zhdukur' nuk ishin krahasuar apo bashkuar nga ana e këtij Misioni pas dorëzimit të këtyre dosjeve. Duket që prioritet i ishte dhënë dosjeve të 'krimeve të luftës' 'në bazë të vlerësimit se një verifikim i dyanshëm i të gjitha dosjeve ka kërkuar që lihet në pritje të paktën pjesërisht puna në hetimet e hapura që ishin trashëguar nga UNMIK-u'.
32. Parashtrësas e këtij Misioni e bëjnë të qartë se kategorizimi i lëndëve dhe dosjeve të lëndëve të pranuar nga UNMIK-u ishte një 'sfidë e madhe' për EULEX-in për shkak të madhësisë së kësaj çështjeje dhe papërshtatshmërisë së disa klasifikimeve të UNMIK-ut. Në kohën e dorëzimit, dosja e rastit të z. Krivokapić ishte e një 'personi të zhdukur'. Për ta adresuar këtë sfidë, EULEX-i është dashur t'i bëjë disa rishikime të dosjeve të UNMIK-ut. Ky proces i mundimshëm ishte komplikuar edhe më tej nga çështjet që kishin të bënin me personelin dhe rikonfigurimin e këtij Misioni, gjë që ka rezultuar me mungesën e dokumenteve, raporteve apo fotografive në disa dosje të rasteve të

caktuara. Po ashtu, janë bërë rishikimet e radhës të dosjeve të lëndëve në vitet 2009, 2010 dhe 2013.

33. Ky Mision gjithashtu thekson se, në përgjithësi, i ka hetuar dhe ndjekur penalisht një numër të rasteve të zhdukjeve të detyruara 'në kuadër të rasteve të krimeve të luftës.
34. Sipas regjistrave të EULEX-it, megjithatë, 'nuk ka pasur përfshirje të këtij Misioni në hetimin e zhdukjes së z. Arsenije Krivokapić. Në veçanti, asnjë intervistim nuk del të jetë bërë nga ky Mision me dëshmitarët apo informuesit e mundshëm.
35. Ky Mision thekson se ai nuk është në dijeni të ndonjë hetimi në proces të këtij rasti nga ana e autoriteteve vendase.
36. Parashtresat e këtij Misioni bëjnë të ditur se ai nuk ka ndërmarrë asnjë hap për t'i kontaktuar apo informuar të afërmit e z. Krivokapić lidhur me ndonjë aspekt të këtij rasti. Lidhur me këtë do të kërkohen sqarime nga ky Mision.
37. Përfundimisht, përkitazi me pyetjen për përputhshmërinë e këtij Misioni me obligimet e tij për të drejtat e njeriut, ky Mision fillimisht thekson praktikën gjyqësore dhe parimet që burojnë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me 'shpejtësinë e arsyeshme' të pritur nga ankuesit në parashtrimin e kërkesës në rastet e shkeljes së vazhdueshme të pretenduar të drejtave të njeriut. Për aplikimin e këtyre standardeve në këtë rast, ky Mision parashtron se ankuesi (ose të afërmit e tjerë) nuk kanë kontaktuar asnjëherë me këtë Mision dhe parashtron se vonesa në paraqitjen e ankesës në Panel (17 vjet pas zhdukjes) është 'e tepërt' dhe e 'pashpjegueshme'. Mbi këtë bazë, ky Mision parashtron se ankesa duhet të shpallet e papranueshme.
38. Ky Mision nuk ka ndonjë vërejtje tjetër për pranueshmërinë e këtij rasti.
39. Më 21 gusht 2019, Paneli ka kërkuar sqarime nga ky Mision nëse ndonjë dosje e rastit i është përcjellë autoriteteve vendase të Kosovës në kohën e tranzicionit të këtij Misioni në vitin 2018.
40. Në përgjigje, përmes një emaili të datës 23 gusht 2019, ky Mision ka sqaruar se 'të gjitha dokumentet e përmendura në përgjigjet e EULEX-it të datës 26 qershor 2019 ishin transferuar tek autoritetet vendase si pjesë e procesit të pranim-dorëzimi. Me sa kuptojmë ne ky rast ishte transferuar si dosje e personit të zhdukur.'

Përgjigja e ankuesit

41. Ankuesit i është kërkuar që të bëjë parashtresat plotësuese jo më vonë se më 24 korrik 2019 por ai nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi.

V. VLERËSIMI I PANELIT

Mandati i Panelit (Rregulla 25 paragrafi 1 i Rregullores së Punës)

42. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohet në Konceptin e Përgjegjshmërisë së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike.
43. Para shqyrtimit të ankesës mbi meritat e saj, Paneli duhet të vendosë nëse duhet të vazhdojë me ankesat, duke i marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
44. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX Kosova gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të tij.
45. Paneli tashmë ka vendosur në rastet e kaluara që ankesat si kjo e tanishme kanë ardhur në parim në suaza të fushëveprimit të kompetencave të tij. Nuk ekziston ndonjë arsye bindëse për t'u shmangur nga ky qëndrim në lidhje me këtë ankesë. Në këtë kontekst, Paneli duhet të ri-përsërisë se hetimi i rasteve të 'zhdukjeve të detyruara' jo vetëm që përbënte pjesë të mandatit të këtij Misioni, por edhe ishte element thelbësor dhe esencial i tij. Në rastin L.O. kundër EULEX-it, Paneli ka nënvizuar se 'nuk ka asnjë dyshim se hetimi i fatit të zhdukurve, pa dallim feje apo etnie, duhet të jetë dhe duhet të mbetet prioritet operacional për EULEX-in si Mision i Sundimit të Ligjit për të cilën ai duhet të pajiset me burime të mjaftueshme' (L.O. kundër EULEX-it, rasti Nr. 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 47).

Përputhshmëria me rregullën e 6 muajve dhe kompetenca racione temporis

46. Siç u diskutua më sipër (shih, *supra*, para. 37), ky Mision i ka tërhequr vëmendjen Panelit në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me parimin e shpejtësisë të arsyeshëm në lidhje me paraqitjen e ankesës dhe ka parashtuar se kjo ankesë nuk i plotësonte këto standarde dhe duhej të shpallej si e papranueshme mbi këtë bazë.
47. Si një çështje preliminare, Paneli duhet të theksojë se kushtet e pranueshmërisë janë përcaktuar në Rregulloren e Punës së tij. Lidhur me afatin kohor, Rregullorja i parasheh kushtet e mëposhtme (Rregulla 25, paragrafët 2-4):
 2. Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkelje të dyshuara të drejtave të njeriut, të cilat kanë ndodhur pas datës 9 dhjetor 2008 në Kosovë.
 3. Ankesat duhet të dorëzohen në Panel brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

4. Pavarësisht nga paragrafi 3, ankesat lidhur me lëndët e transferuara nga EULEX-i në institucionet e Kosovës, duhet të parashtrihen brenda gjashtë muajve nga përfundimi i mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë penale, siç përcaktohet në ligjin e Kosovës ose brenda gjashtë muajve nga transferimi i dosjes së lëndës.
48. Mbi këtë bazë, '[a]nkesat duhet të dorëzohen në Panel brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar. Shih, p.sh., *Gashi v EULEX*, 2013-22, 7 prill 2014, paragrafi 10; *Thaqi v EULEX*, 2010-02, 14 shtator 2009, paragrafi 51.
49. Gjatë aplikimit të këtyre dispozitave, Paneli ka konstatuar se nëse shkelja e të drejtave themelore është e vazhdueshme, afati 6-mujor nuk ka skaduar në parim deri sa të pushojë shkelja. Shih, p.sh., *Zahiti kundër EULEX-it*, 7 qershor 2013, paragrafi 42. Në këtë rast, afati fillon të rrjedhë në datën pas veprimit të kundërshtuar i cili thuhet se e ka shkaktuar ose ka rezultuar në shkeljen e të drejtës. Shih, p.sh., *Y kundër EULEX-it*, 15 nëntor 2012, paragrafët 30-31. Në këtë rast, shkelja e pretenduar ishte e vazhdueshme dhe ka vijuar deri në qershor 2018 kur mandati i këtij Misioni u ndryshua dhe ai e humbi mundësinë për t'i hetuar (apo të vazhdojë t'i hetojë) këto raste.
50. Rregullorja nuk e përcakton ndonjë kriter tjetër për kohën apo 'shpejtësinë e arsyeshme' që do ta rregullonte ose kushtëzonte pranueshmërinë e ndonjë ankese përpara Panelit përveç kriterëve të sipërpërmendura. Vetëm për këtë arsye Paneli mund ta hedh poshtë argumentin e Misionit si jo relevant dhe autoritetet e cituara si të pa aplikueshme në këto procedura. Në të vërtetë do të ishte e padrejtë që një rast të shpallet i papranueshëm në bazë të një kriteri i cili nuk paraqet pjesë të kornizës normative të këtij Paneli.
51. Megjithatë, siç është pranuar në rastin 2017-02, parimi i 'shpejtësisë së arsyeshme' i aplikuar përpara GJEDNJ-së në përgjithësi mëton ta ruajë efektivitetin e të drejtave të ndonjë ankuesi derisa në të njëjtën kohë i shmang vonesat e panevojshme të cilat mund të ndikojnë në atë qëllim dhe krijojnë një gjendje të pasigurisë së përhershme ligjore. Shih Zufe Miladinović kundër EULEX-it, 2017-02, 27 mars 2019, paragrafi 50. Ky është një qëllim të cilin Paneli gjithashtu e ka në mendje që ta ruajë në kontekstin e mandatit të tij derisa ka parasysh specifikat e këtij mandati, të diskutuara më poshtë. Shih gjithashtu D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, Rasti Nr. 2014-11, 2014-12, 2014-13, 2014-14, 2014-15, 2014-16, dhe 2014-17, 30 shtator 2015, paragrafët 94-97; Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it, Rasti Nr. 2014-34, 29 shtator 2015, paragrafët 43-48; Dragiša Kostić kundër EULEX-it, Rasti Nr. 2016-10, 19 qershor 2019, paragrafët 37-45.
52. Me qëllim të zgjidhjes së kësaj çështjeje, Paneli konstaton si në vijim. Së pari, nëse parashtrirat e ankuesit pranohen, shkelja e pretenduar e të drejtave të tij do të ishte e vijueshme përgjatë gjithë kohës relevante deri në qershor 2018, d.m.th., edhe *pas* ai e kishte parashtruar ankesën e tij në Panel.
53. Së dyti, kompetenca dhe përgjegjësia e Misionit për hetimin e këtij lloji të rasteve ka ekzistuar, *proprio motu*, si çështje e ligjit. Ajo nuk është varur dhe nuk është kushtëzuar nga ajo nëse të afërmit e të zhdukurit e kanë kërkuar këtë formalisht apo nëse e kanë kontaktuar Misionin për këtë. Në këtë rast si ky i tanishmi, EULEX-i është në fakt

përgjegjës për të vepruar *proprio motu* me qëllim të sigurimit që zhdukja të hetohet me kujdes, menjëherë dhe në mënyrë efektive. Shih, p.sh., L.O. kundër EULEX, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 63, dhe referencat e tij në GJEDNJ: Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë, Padia nr. 21689/93, Aktgjykimi i datës 6 prill 2004, paragrafi 310; Isayeva kundër Rusisë, Padia nr. 57950/00, Aktgjykimi i datës 24 shkurt 2005, paragrafi 210. Shih gjithashtu, në përgjithësi, Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, paragrafi 41; L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 63; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 29 shtator 2015, paragrafi 46 (“kompetenca e prokurorëve të EULEX-it për të hetuar shkeljet e pohuara të këtyre të drejtave është e pavarur prej ndonjë ankese të paraqitur nga viktimat apo prej të afërmeve të tyre, pra ka pasur një pritje ligjrisht të bazuar se ata do ta shqyrtonin këtë rast, pavarësisht nga veprimet e ankueses.”); D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendim për pranueshmëri, 30 shtator 2015, paragrafi 97.

54. Prandaj, Misioni do të ishte nën obligimin për të hetuar prej momentit kur është njoftuar për ekzistimin e këtij rasti (d.m.th., fundi i 2008 – fillimi i 2009). Dhe, sipas regjimit të aplikueshëm, ai do të kishte qenë kompetent për ta filluar një hetim *proprio motu* deri në maj/qershor 2014 dhe, pas kësaj kohe, në bazë të klauzolës “rrethana të jashtëzakonshme” të Ligjit të rishikuar për Kompetencat. Andaj, në rastin *Sadiku-Syla*, Paneli ka thënë si vijon:

“[S]HM pohon se legjislacioni i ri që ka hyrë në fuqi me 17 Maj 2014 e ka “ulur ndjeshëm mundësinë e prokurorëve dhe gjyqtarëve të EULEX-it për të ushtruar funksione ekzekutive në lëndë të reja” (Përgjigje, fq. 6, duke iu referuar Ligjit omnibus që e ka ndryshuar Ligjin për Kompetencat). Megjithatë Paneli vëren se Neni 7(A) parashikon “Autoritetin e prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme”: “Në rrethana të jashtëzakonshme një lëndë do t’i caktohet një prokurori të EULEX-it me një vendim të përbashkët nga Kryeprokurori i shtetit dhe autoriteti kompetent i EULEX KOSOVA. “SHM nuk ka arritur të shpjegojë pse kjo dispozitë nuk ofron ndonjë bazë të duhur ligjore mbi të cilën prokurorët e EULEX-it duhet të veprojnë, në mënyrë të veçantë në një rast të tillë si kjo lëndë, ku autoritetet vendase nuk duket se janë duke bërë hetime. Paneli i fton palët që ta adresojnë këtë çështje nëse dëshirojnë të bëjnë parashtesa shtesë në lidhje me meritat e kësaj lënde.”

Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 29 shtator 2015, paragrafi 62. Shih edhe, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, paragrafi 90; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 19 tetor 2016, paragrafët 23 et seq.

55. Për më shumë, Paneli konstaton se në bazë të OPLAN-it të rishikuar, siç është pasqyruar në Rregullën 25(4) të Rregullores së Punës të Panelit, ankesat lidhur me rastet e transferuara nga EULEX-i te institucionet e Kosovës duhet të parashtrohen brenda gjashtë muajve prej përfundimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë penale e përkufizuar në ligjin e Kosovës apo brenda gjashtë muajve prej transferimit të dosjeve të lëndës. Duke e pasur parasysh se ky rast ishte transferuar si

pjesë e periudhës kalimtare, afati për parashtrimin e ankesës nuk kishte skaduar ende në kohën e parashtrimit të kësaj ankese.

56. Së treti, nga parashtrësas e Misionit duket sikur ky rast i është përcjellë këtij Misioni si një rast 'i hapur' ose 'në vijim' nga UNMIK-u pasi që nuk ishin gjetur asnjë nga mbetjet mortore të z. Krivokapić dhe se nuk ishte marrë asnjë vendim formal për ta mbyllur atë. Me fjalë tjera, ky rast ishte në dosjet e UNMIK-ut dhe pastaj në dosjet e Misionit megjithëse kishte mbetur joaktiv për gati dy dekada.
57. Së katërti, nga parashtrësas e tij është e dukshme që ky Mision nuk ndërmori asnjë hap për t'i kontaktuar apo intervistuar të afërmit e të zhdukurit; si dhe nuk i ka ofruar këtyre të afërmeve asnjë informacion që e kishte në posedim. Në këto rrethana, është e paqartë nëse të afërmit e z. Krivokapić e kanë marrë vesh ndonjëherë se ky Mision kishte në posedim të tij informata përkitazi me zhdukjen e tij.
58. Së pesti, gjatë vlerësimit të sjelljes së ankuesit në këtë rast, duhet të merren parasysh një numër i faktorëve:
 - i. Ka të bëjë me natyrën e veprimeve në fjalë. Në një rast të kësaj natyre, '[d]uhet të ketë masa për pasigurinë dhe konfuzionin që shpesh shënojnë pasojat e zhdukjeve. Shih *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* paragrafët 162-163; dhe Zufe Miladinović kundër EULEX-it, 2017-02, 27 mars 2019, paragrafi 51. Paneli pajtohet. Gjykata më pas thotë se 'natyra e rëndë e zhdukjeve është e atillë që standardi i shpejtësisë që pritet nga të afërmit nuk mund të jetë shumë i rreptë në kontekstin e mbrojtjes së Konventës'. Shih *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* paragrafët 162-163; dhe Zufe Miladinović kundër EULEX-it, 2017-02, 27 mars 2019, paragrafi 51.
 - ii. Po ashtu duhet shqyrtuar faktin që një numër i institucioneve ishin përgjegjëse njëra pas tjetrës për të 'bërë diçka lidhur me' këtë rast: UNMIK-u, EULEX Kosova dhe tani autoritetet vendase. Edhe institucione tjera kanë luajtur një rol në lidhje me rastet e zhdukjeve të detyruara, përfshirë KNKK-në. Ankuesi dhe të afërmit e tij në këtë rast e kanë raportuar këtë rast në disa prej këtyre organizatave (shih, *supra*, paragrafi 13). Në këtë kuptim, ato vështirë se mund të thuhet që ishin joaktive. Përkundrazi, asnjë prej këtyre institucioneve në dukje nuk ka kryer ndonjë hetim të këtij rasti. Për më tepër, siç shihet nga parashtrësas e një ankuesi tjetër në një rast të ngjashëm (2016-12), viktimat e shkeljeve të drejtave mund të ishin ngatërruar nga radhët e autoriteteve kompetente dhe mbase nuk ishte plotësisht e paarsyeshme nga ana e tyre që të supozonin se, duke e njoftuar organizatën përgjegjëse për të hetuar në kohën më të afërt me zhdukjen (d.m.th. UNMIK-un) nuk ishte e domosdoshme përsëri që të kontaktonin edhe një herë organizatën që i mori përsipër rastet nga ai (d.m.th. EULEX Kosova).
 - iii. Një specifikë tjetër e rëndësishme që e karakterizon punën e këtij Misioni dhe llogaritjen e kohës për të paraqitur ankesë para Panelit është fakti që ky Mision u krijua një dekadë pas ngjarjeve përkatëse. Pas kësaj kohe, u deshën vite të tjera që Misioni ta fillojë hetimin e rasteve të llojit që janë duke u shqyrtuar tani.

Në këtë kuptim, përpara se një ankues madje mund të mendonte të paraqiste një ankesë në Panel duke pretenduar një dështim nga ana e këtij Misioni, më shumë se një dekadë do të kishte kaluar tashmë. Kjo situatë e veçantë duhet domosdoshmërisht të merret parasysh kur vendoset nëse ndonjë ankues ka vepruar në kohën e duhur kur ankohet për mos veprim nga ana e Misionit.

- iv. Gjithashtu, në kontekstin aktual, është i rëndësishëm fakti që, si viktimat të përkatësisë etnike serbe, të paktën për ca kohë do të ishte e ndërlikuar personalisht dhe praktikisht për ta kërkuar ndihmën e autoriteteve në Kosovë.
59. Për më tepër, për të vendosur nëse kishte ende gjasa të arsyeshme për një hetim në këtë rast, duhet të theksohet si më poshtë. Së pari, Misioni kishte në dispozicion të tij informacione që kishin të bënin me atë rast që të paktën duhej t'u kërkonte organeve të tij të shqyrtonin nëse do ta fillonin apo jo një hetim. Arsyeja pse ai duket se ka zgjedhur të mos e bëjë këtë vlerësim është e paqartë. Në këtë drejtim, mbase është menduar që pistat e mundshme të hetimit, në veçanti, intervistimi i të pranishmëve në kohën e zhdukjes; intervistimi i familjarëve të cilët mund të posedojnë informacione përkatëse; hetimi i rasteve të ngjashme në atë zonë në atë kohë; hetimi i autorëve të mundshëm ose njësitëve të njohura aktive në atë zonë në atë kohë, janë shqyrtuar me qëllim të përcaktimit të mundësisë dhe qëndrueshmërisë së hetimit. Nuk është e paarsyeshme të supozohet se, nëse janë shqyrtuar këto, mund të ishte marrë vendimi për ta filluar ose jo hetimin e plotë. Së dyti, siç u cek më sipër, hetimi dhe ndjekja penale e këtij lloji të çështjeve qëndronte në thelbin e përgjegjësisë të Misionit për Sundimin e Ligjit dhe ky Mision me të vërtetë i ka hetuar një numër të këtyre rasteve disa dekada pas zhdukjes së viktimave. Mbi këtë bazë, nuk do të ishte e paarsyeshme të supozohej se ai mund ta kishte hetuar edhe këtë rast. Duke e ditur këtë, mund të duket naive sikur ankuesi do ta kishte vendosur besimin e tij në mundësinë e një hetimi nën mbikëqyrjen e EULEX-it për kaq shumë vite, por kjo pritshmëri nuk ishte e paarsyeshme në kuptimin e shqyrtimeve të përshkruara më sipër dhe në kuptimin e përgjegjësisë thelbësore të këtij Misioni në lidhje me këtë lloj rastesh. Për më tepër, siç theksohet nga GJEDNJ, nuk mund të mos jetë e paarsyeshme që një i afërm i një personi të zhdukur të presë për disa vjet "derisa shpresa e përparimit [që] po bëhet të jetë zhdukur në mënyrë efektive" (Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë, paragrafët 162-163; Zufe Miladinović kundër EULEX-it, 2017-02, 27 mars 2019, paragrafët 50-51).
60. Për më tepër, vonesa në paraqitjen e ankesës e pretenduar nga Misioni nuk duket se ka shkaktuar ndonjë paragjykim për sa i përket procedurave para Panelit. Shih Zufe Miladinović kundër EULEX-it, 2017-02, 27 mars 2019, paragrafi 59. Interesi që Misioni mund ta ketë për zbatimin e rreptë të afatit 6-mujor gjithashtu duhet të interpretohet në këtë kuptim.
61. Prandaj, në kuptim të gjitha këtyre rrethanave, vonesa që i është ngarkuar ankuesit nuk mund të thuhet se është e tepërt ose e pashpjegueshme pasi ankuesi ka vazhduar të kërkojë dhe t'i kontaktojë ato autoritete për të cilat ai ka menduar se mund të ndihmonin për ta çuar këtë hetim përpara. Edhe sot e kësaj dite ekziston një interes i fuqishëm dhe detyrues që kjo çështje të hetohet në mënyrë të plotë dhe efektive.

62. Në këto rrethana, Paneli është i bindur që ankuesi i ka plotësuar kriteret e Rregullores dhe se ankesa e tij ishte paraqitur në kohën e duhur. Sidoqoftë, fakti që ka kaluar kaq shumë kohë nga zhdukja e z. Krivokapić mund të ndikojë në lehtësimin që Paneli mund ta jepte nëse ankesa të ketë sukses në meritat e saj.
63. Paneli thekson që, *ratione temporis*, ai është kompetent që t'i shqyrtojë veprimet e këtij Misioni deri më 14 qershor 2018. Pas kësaj date, Misioni nuk kishte ndonjë përgjegjësi ekzekutive në lidhje me këtë rast. Veprimet e kryera pas kësaj date mund të jenë relevante, megjithatë, për ta vlerësuar shkallën në të cilën mund të thuhet se ky Mision i ka përmbushur detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Prandaj, Paneli fton Misionin që të ofrojë referenca në parashtrimet e veta për çfarëdo përpjekje të ndërmarrë nga ky Mision për të siguruar që ky rast ishte apo është duke u hetuar (nëse po), përfshirë pas kësaj date.

Kompetenca ratione materiae e Panelit

64. Misioni nuk e konteston kompetencën *ratione materiae* të Panelit lidhur me këtë rast dhe Paneli në fakt është i bindur që është kompetent lidhur me këtë çështje. Ky rast në mënyrë të qartë bën pjesë në kuadër të kompetencave ekzekutive (hetimore) të organeve të këtij Misioni, të cilat në fakt i kanë shqyrtuar dosjet e lëndës të këtij rasti dhe kanë rekomanduar hetimin e mëtejshëm.
65. Në konsekuencë me rastet e mëparshme që kanë të bëjnë me çështje të ngjashme, Paneli është i bindur se është kompetent *ratione materiae* për t'u marrë me këtë çështje.

Liria e lëvizjes dhe diskriminimi i bazuar në përkatësinë etnike

66. Siç u theksua më sipër, ankuesi gjithashtu pretendon se të drejtat e tij për lirinë e lëvizjes dhe mbrojtjen nga diskriminimi (etnik) ishin shkelur nga ky Mision.
67. Paneli nuk ka gjetur ndonjë provë zyrtare e cila do ta mbështeste këtë parashtrim.
68. Prandaj, Paneli e konsideron këtë pjesë të ankesës si të pa meritë dhe qartazi të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

SHPLL TË PRANUESHME, pa paragjykuar meritat e çështjes, ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

SHPLL TË PAPANUESHME ankesën për pjesën e mbetur;

KËRKON NGA PALËT QË T'I ADRESOJNË PYETJET NË VIJIM në lidhje me meritat e këtij rasti,

i. Për Misionin:

1. Çfarë hapi(a), nëse ka, ishin ndërmarrë nga Misioni apo ndonjë nga organet e tij për ta hetuar këtë rast?
2. A ka ndërmarrë Misioni ndonjë hap për t'i kontaktuar apo ofruar informata të afërmve të z. Krivokapić lidhur me këtë rast? Nëse po, cilat hapa?
3. Çfarë, nëse ka, është në gjendje të bëjë ky Mision në mënyrë që të sigurojë që autoritetet vendase t'i përmbushin detyrimet e tyre për të drejtat e njeriut në lidhje me ankuesin?
4. Në letrën tuaj të datës 26 qershor 2019 (faqe 8), thuhet se sipas të dhënave tuaja ky mision nuk ka qenë i përfshirë në hetimin e zhdukjes së z. Arsenije Krivokapić.
 - a. Pse nuk e ka hetuar Misioni këtë rast?
 - b. Kur ishte marrë ky vendim?
 - c. A i ishte komunikuar ai të afërmve të z. Krivokapić?
5. A u është dhënë autoriteteve vendase dosja e lëndës lidhur me rastin e z. Arsenije Krivokapić? Nëse po, kur? Nëse jo, pse?
6. Në parashtrësat tuaja të datës 26 qershor 2019, ju e keni diskutuar një raport ante-mortem të vitit 2008 të përgatitur nga një zyrtar policor i UNMIK-ut. Ju më tej theksoni (fq. 4 e letrës suaj) se ky dokument nuk i ishte përcjellë PSRK-së për vlerësim. Ju lutemi tregoni se cili organ i Misionit e kishte pranuar atë dokument nga UNMIK-u? Po ashtu, ju lutemi tregoni pse nuk i ishte përcjellë ai PSRK-së?
7. A ka bërë shkelje apo a ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas Neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?

ii. Për ankuesin:

1. Çfarë kontakti, nëse ka, keni pasur ju me Misionin EULEX Mision apo me përfaqësuesit e tij?

2. A jeni në dijeni për ndonjë përpjekje nga autoritetet vendase për ta hetuar këtë rast?
3. A ka bërë shkelje apo a ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas Neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
4. Cilat janë pasojat personale, financiare, ligjore dhe emocionale që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?

KËRKON nga palët që t'i ofrojnë përgjigjet e tyre për sa më sipër jo më vonë se më 11 nëntor 2019.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare

Anna AUTIO
Anëtare